

LIGJ
Nr. 123/2014

PËR URDHRIN E MJEKËVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

(Ndryshuar me aktin normativ nr. 2 datë 1.8.2024¹; me ligjin nr. 99/2024, datë 12.9.2024; me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 58, datë 15.10.2025)

(I përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi i ligjit

Ligji ka si qëllim përcaktimin e rregullave të organizimit dhe të veprimtarisë së Urdhrit të Mjekëve dhe marrëdhëniet juridike të profesionistëve mjekësorë.

Neni 2

Fusha e zbatimit

(ndryshuar term me aktin normativ nr. 2 datë 1.8.2024)

Ky ligj zbatohet për të gjithë mjekët që ushtrojnë profesionin në Republikën e Shqipërisë në sistemin publik apo jopublik.

Neni 3

Statusi

Urdhri i Mjekëve është ent publik jobuxhetor, profesional, i pavarur, i cili përfaqëson dhe mbron interesat e përbashkët të anëtarëve të Urdhrit dhe rregullon veprimtaritë dhe marrëdhëniet midis tyre, në funksion të publikut.

KREU II
MISIONI DHE BUXHETI

Neni 4

¹ Akti normativ nr. 2, datë 1.8.2024 është miratuar me ligjin nr. 94/2024, datë 12.9.2024.

Misioni

(ndryshuar fjalë në shkronjën b) të pikës 2 me aktin normativ nr. 2 datë 1.8.2024)

1. Misioni i Urdhrit të Mjekëve është ruajtja e standardeve të larta në formimin dhe ushtrimin e profesioneve në fushën e mjekësisë dhe mbrojtja e pacientëve dhe publikut nga kequshtrimi i profesionit të mjekut.

2. Për të përmbushur misionin e tij, Urdhri i Mjekëve ushtron këto kompetenca:

a) jep dhe heq licencën individuale të ushtrimit të profesionit;

b) harton standarde etike dhe deontologjike, të detyrueshme për çdo mjek dhe monitoron zbatimin e tyre gjatë ushtrimit të profesionit;

c) rivlerëson periodikisht kompetencën dhe performancën profesionale të anëtarit të Urdhrit përballë standardeve të vendosura;

ç) nxit arritjen e standardeve të larta në edukimin dhe formimin profesional dhe etik të anëtarëve të Urdhrit;

d) bashkëpunon me Qendrën Kombëtare të Edukimit në Vazhdim, institucione të tjera shkencore dhe arsimore për të siguruar standarde të larta në Edukimin e Vazhdueshëm Mjekësor, kualifikimet dhe specializimet pasuniversitare të Urdhrit;

dh) mban Regjistrin Themeltar të Urdhrit dhe menaxhon sistemin e administrimit dhe përditësimit të tij;

e) mbron të drejtat e anëtarëve të Urdhrit, integritetin moral dhe profesional të tyre e të profesionit mjekësor.

Neni 5

Kriteret e anëtarësisë

(shtuar shkronja d) e pikës 2 dhe ndryshuar term në pikën 1 me aktin normativ nr. 2 datë 1.8.2024)

1. Asnjë individ nuk mund të ushtrojë profesionin e mjekut, në sistemin e kujdesit shëndetësor publik apo jopublik në Republikën e Shqipërisë, pa qenë anëtar i Urdhrit të Mjekëve dhe pa qenë i pajisur me licencën për ushtrimin individual të profesionit, të lëshuar nga ky organizëm.

2. Janë anëtarë të Urdhrit të Mjekëve të gjithë mjekët që ushtrojnë profesionin e mjekut/mjekut specialist në Republikën e Shqipërisë dhe që përmbushin kriteret e mëposhtme:

a) të jenë shtetas shqiptarë;

b) të kenë diplomën e mjekut, mjekët specialistë edhe diplomën e specialitetit, të lëshuar nga institucioni i arsimit të lartë brenda apo jashtë shtetit, të njohura nga ministria përgjegjëse për arsimin;

c) të mos jenë të dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje, në momentin e kërkesës për anëtarësim;

ç) të njohin dhe të zotohen me shkrim se do të zbatojnë kërkesat e legjislacionit në fuqi, statutit, Betimin e Mjekut dhe Kodin e Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore.

d) nuk janë larguar me masën disiplinore të heqjes së licencës.

3. Çdo mjek, shtetas i huaj, që të ushtrojë profesionin si rezident në Shqipëri, apo i atashuar në një institucion shëndetësor ku vjen periodikisht për ushtrimin e profesionit, duhet të ketë edhe këto dokumente:

a) lejen e qëndrimit dhe të punës në Republikën e Shqipërisë;

b) certifikatën e mirësjelljes (Good Standing Certificate) nga Urdhri/dhoma apo shoqata e

mjekëve të vendit të vet, ku vërtetohet se është i regjistruar, e ushtron profesionin dhe se nuk ka marrë masa ndëshkimore;

c) njësimin (konvalidimin) e diplomës dhe certifikatave të specializimeve të kryera prej tij/saj;

ç) një rekomandim nga një specialist vendas i së njëjtës fushë, anëtar i Urdhrit të Mjekëve;

d) dëshmi të njohjes së gjuhës shqipe, të vërtetuar nga një autoritet i licencuar nga shteti.

Mjeku jorezident detyrimisht punon me përkthyes.

Neni 6

Të drejtat e anëtarit të Urdhrit të Mjekëve

Anëtari i Urdhrit të Mjekëve ka të drejtë:

1. Të ushtrojë profesionin në profilin e vet;

2. Të ankohet në organet e Urdhrit kur i shkelen të drejtat dhe mundësitë për ushtrim autonom, të lirë dhe të pavarur të profesionit nga cilido qoftë;

3. Të marrë pjesë në shqyrtimin nga orga-nizmat e Urdhrit për probleme që kanë të bëjnë me personin e tij;

4. Të kërkojë krijimin e kushteve të favorshme për ushtrimin normal të profesionit, për Edukimin e Vazhdueshëm Mjekësor dhe për përparimin e karrierës.

Neni 7

Ndërprerja e anëtarësimit

(ndryshuar shkronja b) e pikës 1 me aktin normativ nr. 2 datë 1.8.2024)

1. Anëtarit të Urdhrit të Mjekëve i ndërpritet anëtarësia në këto raste:

a) kur vdes;

b) kur i hiqet licenca individuale e ushtrimit të profesionit me vendim disiplinor apo me vendim gjykatë;

c) kur është duke vuajtur dënimin penal me heqje lirie;

ç) kur nuk shlyhen kuotizacionet në përputhje me afatet e vendosura nga Këshilli Kombëtar i Urdhrit dhe i kalon ato mbi 1 vit pa arsye të justifikueshme.

2. Vendimi për ndërprerje të anëtarësisë i komunikohet zyrtarisht personit dhe institucionit ku ka shërbyer i ndëshkuari.

Neni 8

Detyrimet e anëtarëve të Urdhrit

(shtuar shkronja ç) dhe d) me aktin normativ nr. 2 datë 1.8.2024)

Anëtari i Urdhrit të Mjekëve ka këto detyrime:

a) të ushtrojë profesionin dhe të ketë sjellje profesionale, në përshatje me kërkesat dhe standardet e legjislacionit shqiptar në fushën e shëndetësisë, Kodin e Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore dhe statutin;

b) të punojë për rritjen e standardeve profesionale dhe të cilësisë së kujdesit shëndetësor në institucionin ku punon dhe të marrë pjesë rregullisht në programet e Edukimit të Vazhdueshëm Mjekësor;

c) të paguajë rregullisht kuotizacionet e anëtarësisë, tarifat e regjistrimit, të dhënies së të

drejtës së ushtrimit të profesionit dhe shërbime të tjera administrative, në përputhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

ç) të mos punojë në sistemin shëndetësor jopublik më shumë se 30 për qind të orëve mujore, që punon në sistemin shëndetësor publik;

d) të mos u kërkojë pacientëve, që i janë paraqitur në institucionin shëndetësor publik për trajtim dhe shërbime, në përputhje me specialitetin e tij, që t'i drejtohen institucionit shëndetësor jopublik, ku ai ushtron profesionin e tij.

Neni 8/a

(Shtuar me aktin normativ nr. 2 datë 1.8.2024; shfuqizuar pikat 1, 3, 5, 7 dhe 9 me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 58, datë 15.10.2025)

Kushtet dhe procedura që një mjek në një institucion shëndetësor publik mund të ushtrojë profesionin në një institucion shëndetësor jopublik

1. Shfuqizuar.

2. Në kuptim të këtij ligji, termi “ushtrim i profesionit të mjekut” përfshin hapjen, pjesëmarrjen, si edhe punësimin në një institucion shëndetësor jopublik.

3. Shfuqizuar.

4. Anëtarët e Urdhrit të Mjekëve, që mbajnë funksione drejtuese të çdo niveli në një institucion shëndetësor publik dhe në Universitetin Mjekësor Publik, nuk mund të mbajnë funksione drejtuese të çdo niveli në një institucion shëndetësor jopublik.

5. Shfuqizuar.

6. Në çdo rast, angazhimi i mjekut në institucionin shëndetësor jopublik nuk duhet të pengojë kryerjen e detyrës së tij/saj në institucionin shëndetësor publik, ose kjo veprimtari nuk duhet të kërkojë një angazhim mendor a fizik të tij/saj, që e bën të vështirë kryerjen e kësaj detyre, ose ushtrimi i kësaj detyre në institucionin shëndetësor jopublik mund të cenojë, në çfarëdo mënyre, imazhin e mjekut.

7. Shfuqizuar.

8. Ministria përgjegjëse për shëndetësinë bën publikimin e të dhënave të këtij mjeku në një regjistër publik elektronik.

9. Shfuqizuar.

Neni 9

Bashkëpunimi

(ndryshuar emërtesë në pikën 3 me aktin normativ nr. 2 datë 1.8.2024; ndryshuar emërtesë në pikën 3 me ligjin nr. 99/2024, datë 12.9.2024)

1. Urdhri i Mjekëve, gjatë veprimtarisë së tij, bashkëpunon me ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë dhe institucionet e saj vartëse, si dhe me ministritë, institucionet qendrore, institucionet e arsimit të lartë dhe organizma të tjerë, publikë ose jopublikë, të krijuara sipas legjislacionit në fuqi.

2. Urdhri i Mjekëve informon çdo 6 muaj ministrinë përgjegjëse për fushën e shëndetësisë lidhur me anëtarësimet, gjykimet disiplinore dhe probleme të tjera me interes të ndërsjellë. Ky informacion publikohet edhe në faqen e internetit të Urdhrit.

3. Struktura përgjegjëse për inspektimin në shëndetësi bashkëpunon me Urdhrit e Mjekëve gjatë ushtrimit të funksionit të tij.

4. Ministria e Shëndetësisë bashkëpunon me Urdhrit e Mjekëve për hartimin e projektligjeve dhe të dokumenteve të rëndësishme në fushën e shëndetësisë.

Neni 10

Buxheti

1. Urdhri i Mjekëve ka buxhetin e tij, të cilin e miraton dhe e administron Këshilli Kombëtar, në përputhje me rregullat financiare në fuqi dhe me rregulloren e brendshme për veprimtarinë financiare të Urdhrit, të miratuar nga ky këshill.

2. Burimet financiare të Urdhrit janë:

a) kuotizacionet e anëtarëve, masa e të cilave përcaktohet me vendim të Këshillit Kombëtar dhe janë të detyrueshme për çdo anëtar;

b) tarifet e vendosura për aktet dhe dokumentet e lëshuara nga Urdhri;

c) donacione të ndryshme dhe të ardhura të tjera të ligjshme.

3. Të ardhurat e siguruara, sipas përcaktimit të bërë në pikën 2, të këtij neni, Urdhri i përdor për të përmbushur synimet dhe objektivat e tij në përputhje me statutin dhe me këtë ligj.

KREU III

ORGANIZIMI DHE DREJTIMI

Neni 11

Organet kryesore

(shfuqizuar shkronja ç) e pikës 1 me aktin normativ nr. 2 datë 1.8.2024)

1. Organet kryesore të Urdhrit janë:

a) asamblëtë;

b) këshillat;

c) presidentët;

ç) shfuqizuar.

2. Zgjedhjet në organet e sipërpërmendura duhet të sigurojnë përfaqësim në masën 30 për qind për çdo gjini, në përputhje me ligjin nr. 9970, datë 24.7.2008, "Për barazinë gjinore në shoqëri".

Neni 12

Asamblëtë

1. Asambleja Kombëtare është organi më i lartë drejtues i Urdhrit dhe përbëhet nga të gjithë anëtarët e këshillave rajonalë.

2. Mbledhja e Asamblesë Kombëtare thirret nga:

a) Presidenti i Këshillit Kombëtar;

b) kur kërkohet nga 1/3 e të gjithë anëtarëve të asamblesë.

3. Asambleja rajonale zgjedh këshillin rajonal.

4. Përbërja e anëtarëve të asamblesë rajonale dhe procedurat e zgjedhjes së tyre përcaktohen në Statutin e Urdhrit të Mjekëve.

Neni 13

Këshilli Kombëtar

(shtuar fjalë në shkronjën dh) të pikës 2 me aktin normativ nr. 2 datë 1.8.2024)

1. Këshilli Kombëtar përbëhet nga 25 anëtarë, ndër të cilët 20 janë anëtarë të zgjedhur nga Asambleja Kombëtare dhe 5 të tjerët janë, përkatësisht, Presidenti i Urdhrit të Mjekëve, zëvendësi i tij, një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë, një përfaqësues nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, një përfaqësues nga institucionet e arsimit të lartë, të caktuar nga Presidenti i Urdhrit, në bazë të kriterëve të përcaktuara në statut.

2. Këshilli Kombëtar ka këto përgjegjësi:

- a) miraton strukturën e vet organizative dhe të këshillave rajonalë;
 - b) cakton kuotizacionin dhe tarifat;
 - c) zgjedh Presidentin e Urdhrit të Mjekëve dhe zëvendësin e tij;
 - ç) administron pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme të Urdhrit në nivel kombëtar, duke përcaktuar fondet në administrimin e këshillave rajonalë;
 - d) mbikëqyr të gjithë veprimtarinë e organeve që varen prej tij;
 - dh) miraton statutin, rregulloret e Urdhrit si dhe harton Kodin Etik dhe Deontologjik të Mjekut;
 - e) ngre grupe pune *ad hoc* për kryerjen e kontrolleve për ushtrimin e profesionit të mjekut.
3. Zgjedhjet për Këshillin Kombëtar bëhen çdo 5 vjet.
4. Zgjedhjet për Këshillin Kombëtar dhe ato për këshillat rajonalë bëhen në të njëjtën kohë.

Neni 14

Këshillat rajonalë

(shfuqizuar shkronja c) e pikës 2 me aktin normativ nr. 2 datë 1.8.2024)

1. Këshilli rajonal përbëhet nga 5 deri në 9 anëtarë, në varësi të numrit të anëtarëve të Urdhrit të Mjekëve.

2. Këshilli rajonal ka këto funksione:

- a) këshilli rajonal zgjedh presidentin dhe zëvendës-presidentin e tij;
 - b) administron buxhetin dhe të gjitha pasuritë e Urdhrit në nivel qarku;
 - c) shfuqizuar;
 - ç) ngre grupe pune *ad hoc* për kryerjen e kontrolleve për ushtrimin e profesionit të mjekut në nivel qarku.
3. Zgjedhjet për këshillin rajonal bëhen çdo 5 vjet.

Neni 15

Presidentët e Urdhrit

(ndryshuar term në pikën 5 me aktin normativ nr. 2 datë 1.8.2024)

1. Presidentët e Urdhrit zgjidhen me votim të fshehtë nga Këshilli Kombëtar dhe ai rajonal midis jo më pak se 2 kandidaturave alternative.

2. Këshilli Kombëtar zgjedh Presidentin e Urdhrit të Mjekëve me shumicën e votave të gjithë anëtarëve të tij. Mandati i presidentit është 5 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm njëherë.

3. Këshillat rajonalë zgjedhin presidentët përkatës të këshillave rajonalë. Mandati i tyre është 5 vjet me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë.

4. Kandidaturat për presidentë të Urdhrit të Mjekëve duhet të përmbushin këto kritere:

- a) të jenë jo më shumë se në moshën e daljes në pension në momentin e zgjedhjes;
- b) të kenë jo më pak se 15 vjet eksperiencë në profesion;
- c) të kenë përvojë dhe të dhëna të besueshme për aftësi komunikimi, organizimi e drejtimi;
- ç) të mos jenë marrë ndaj tyre masa ndëshkimore disiplinore në 5 vitet e fundit;
- d) të kenë prestigj dhe reputacion etiko-moral dhe profesional;
- dh) të kenë kryer botime shkencore;
- e) të mos jenë të dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje.

5. Funksioni i presidentëve të Urdhrit të Mjekëve është i papajtueshëm me çdo funksion tjetër administrativ, publik apo politik.

6. Presidentët e urdhrave e përfundojnë mandatin e tyre përpara kohe në këto raste:

a) kur merret vendim nga Këshillit Kombëtar ose rajonal, me votat e jo më pak se dy të tretave të anëtarëve;

b) kur japin dorëheqjen;

c) kur dënohen me vendim gjykatë të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale;

ç) kur humbasin zotësinë e plotë për të vepruar;

d) kur bëhen të paaftë, për arsye shëndetësore, për të kryer detyrat e tyre, vërtetuar nga komisioni kompetent mjekësor.

7. Procedura e zgjedhjes, detyrat dhe kompetencat e presidentëve të Urdhrit të Mjekëve përcaktohen në Statutin e Urdhrit.

Neni 16

Komisionet disiplinore

(ndryshuar me aktin normativ nr. 2 datë 1.8.2024)

1. Procedimi disiplinor ushtrohet nga komisioni i disiplinës dhe komisioni i apelimit.

2. Komisioni i disiplinës funksionon pranë Urdhrit të Mjekëve dhe realizon shqyrtimin e ankesave, hetimin administrativ dhe, në rast konstatimi të shkeljeve, cakton me vendim masat disiplinore.

3. Vendimet e komisionit të disiplinës mund të ankimohen brenda 10 (dhjetë) ditëve nga njoftimi i arsyetuar në komisionin e apelit, që ngrihet pranë ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë.

4. Përbërja, organizimi dhe funksionimi i komisionit të disiplinës dhe të komisionit të apelimit rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 17

Masat disiplinore

(ndryshuar me aktin normativ nr. 2 datë 1.8.2024; shfuqizuar shkronja "d" e pikës 1 dhe fjalia e fundit e pikës 3 me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 58, datë 15.10.2025)

1. Komisioni disiplinor heton e gjykon në bazë të fakteve dhe provave të administruara dhe të seancës dëgjimore me anëtarin e Urdhrit të Mjekëve, ndaj të cilit mund të merret masa disiplinore.

Kur vërtetohet se anëtari ka kryer shkelje të etikës, të Kodit të Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore ose ka bërë gabime teknike, ai jep këto masa:

- a) Vërejtje;
- b) Pezullim për të realizuar shërbime të caktuara mjekësore, për një periudhë nga 6 (gjashtë) muaj deri në 3 (tre) vjet;
- c) Pezullim të licencës së ushtrimit të profesionit të mjekut në tërësinë e saj, për një periudhë nga 6 (gjashtë) muaj deri në 5 (pesë) vjet;
- ç) Gjobë me vlerë nga 100 000 (njëqind mijë) lekë deri në 1 000 000 (një milion) lekë;
- d) Shfuqizuar.

2. Procedimi disiplinor fillon brenda 5 (pesë) vjetëve nga momenti i kryerjes së shkeljes. Në rastin kur anëtari i Urdhrit të Mjekëve ushtron detyrën në të njëjtin institucion shëndetësor, ku ka kryer shkeljen disiplinore, procedimi disiplinor fillon menjëherë nga momenti i konstatimit të saj.

3. Masat disiplinore, sipas pikës 1, të këtij neni, shuhen:

- a) për shkronjën “a”, 3 (tre) vjet pas dhënies apo përfundimit të saj;
- b) për shkronjat “b”, “c” dhe “ç”, 5 (pesë) vjet pas përfundimit, përkatësisht, të periudhës së pezullimit apo të pagimit të gjobës.

4. Në caktimin e masave disiplinore, komisioni mban në konsideratë llojin e shkeljes, seriozitetin e saj, pasojat e ardhura, sjelljen e anëtarit të Urdhrit të Mjekëve ndaj këtyre pasojave, si edhe nëse ka pasur më parë shkelje të tjera disiplinore.

Neni 18

Ankimimi gjyqësor

(ndryshuar me aktin normativ nr. 2 datë 1.8.2024)

1. Kundër vendimit të komisionit të apelimit lejohet ankim në gjykatën administrative kompetente brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja dijeni për vendimin.

2. Ankimi në gjykatë nuk pezullon zbatimin e vendimit të komisionit të apelimit.

Neni 19

Kodi i Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore

(ndryshuar pika 2 me aktin normativ nr. 2 datë 1.8.2024)

1. Kodi i Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore është dokumenti themelor i profesionit mjekësor, në të cilin materializohen të gjithë parimet dhe standardet profesionale të detyrueshme për t'u njohur e zbatuar nga çdo anëtar i Urdhrit në praktikën mjekësore, si edhe nga çdo institucion shëndetësor.

2. Këshilli Kombëtar harton Kodin e Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore dhe ia paraqet për miratim ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

KREU IV

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 20

Përmirësimi i dokumenteve të Urdhrit

Këshilli Kombëtar i Urdhrit harton dhe përmirëson Kodin e Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore, statutin dhe rregulloret e tij pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 21 **Transferimi**

1. Jo më vonë se 6 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji, bëhen zgjedhjet e organeve drejtuese të Urdhrit dhe riorganizimi i tyre në përputhje me këtë ligj.

2. Jo më vonë se 6 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji, gjithë dokumentacioni dhe arkivi i lejeve të ushtrimit të profesionit të stomatologut, të dhëna deri në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, i transferohen Urdhrit të Stomatologëve.

Neni 22 **Shfuqizimi**

Ligji nr. 8615, datë 1.6.2000, “Për Urdhrin e Mjekëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe çdo dispozitë tjetër, që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Dispozita tranzitore *(e aktit normativ nr. 2, datë 1.8.2024)*

Anëtarët e Urdhrit të Mjekëve, që janë të punësuar në një institucion shëndetësor publik dhe që ushtrojnë profesionin e mjekut edhe në një institucion shëndetësor jopublik, detyrohen që, brenda dy muajve nga miratimi i udhëzimit të ministrit përgjegjës për shëndetësinë, sipas pikës 6, të nenit 8/a, të ligjit, të rregullojnë statusin e tyre, në përputhje me këtë akt normativ me fuqinë e ligjit.

Neni 23 **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 25.9.2014

**Shpallur me dekretin nr. 8739, datë 14.10.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**